



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Ndikimi i dezinformimit dhe polarizimit politik gjatë pandemisë **COVID-19** në Kosovë



Prishtinë
Qershor 2022

Autorë:

Shpat Balaj and Skënder Perteshi

Recenzente e jashtme:

Garentina Kraja

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat dhe pronësia intelektuale mbrohen nga Ligji Nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +383 38 221 420.

Opinionet e prezantuara në këtë hulumtim janë të autorit dhe jo domosdoshmërisht përfaqësojnë opinionet e donatorëve apo të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë.

Versioni original i këtij raporti është shkruar në gjuhën Angleze. Ky version është përkthim nga origjinali.

Ky raport është publikuar në kuadër të projektit "Pandemia COVID-19 në Kosovë: Identifikimi dhe Trajtimi i Fushatave të Dezinformimit" i mbështetur nga Balkan Trust for Democracy, projekt i Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara dhe USAID-it

Ndikimi i dezinformimit dhe polarizimit politik gjatë pandemisë **COVID-19** në Kosovë

Prishtinë
Qershor 2022

Tabela e përmbajtjes

Rreth autorëve:	1
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	2
HYRJE	4
COVID-19: Peisazhi mediatik, narrativat dhe përkufizimet globale dhe lokale	5
PËRKUFIZIMET: Dezinformimi, keqinformimi, teoritë konspirative dhe lidhja e tyre me informacionin e rremë	8
Narrativat mbizotëruese globale rreth COVID-19	10
Narrativat mbizotëruese rajonale rreth COVID-19	12
POLITIZIMI I PANDEMISË COVID-19 NË KOSOVË	14
RREGULLIMI LIGJOR DHE ASPEKTI I POLITIKAVE PËR DEZINFORMIMIN DHE KEQINFORMIMIN NË KOSOVË	
MJEDISI INFORMATIV I KOSOVËS GJATË COVID-19	20
TEORITË KONSPIRATIVE DHE DEZINFORMIMI RRETH COVID-19	24
REALITETET E PERCEPTUARA DHE COVID-19: PASQYRA E PERCEPTIMEVE PUBLIKE	27
Perceptimet publike ndaj menaxhimit të pandemisë COVID-19	28
Perceptimet e publikut ndaj dezinformimit	31
KONKLUZIONE	35

Rreth autorëve:



Skënder Perteshi është analist dhe hulumtues rreth temave të luftimit dhe parandalimit të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS). Skënderi është autor i raporteve të shumta hulumtuese rreth temave të sigurisë, siç janë lufta kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe ndërtimi i komuniteteve reziliente në Kosovë, diaspora dhe ekstremizmi i dhunshëm, ekstremizmi online dhe offline, integriteti në sektorin e sigurisë. Skënderi ka punuar si bashkëpunëtor i lartë dhe konsulent për çështjet e sigurisë për shumë organizata ndërkombëtare dhe lokale, duke përfshirë Finn Church Aid Foundation–Helsinki, Royal United Services Institute (RUSI), Organizata Ndërkombëtare e Migracionit (IOM), OSBE në Kosovë, kompania konsulente MOONSHOT në Londër, Resolve Network USA dhe të tjerë.



Shpat Balaj është hulumtues dhe menaxher projekti në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë. Shpati ka realizuar disa punime hulumtuese, përmbledhje të politikave dhe artikuj mbi përfshirjen e komuniteteve jo-shumicë, integritetin në sektorin e sigurisë, dezinformimin, si dhe çështjet e ekstremizmit të dhunshëm. Me më shumë se 7 vjet përvojë si në sektorin joqeveritar ashtu edhe në atë privat, Shpati ka eksperiencë të gjerë në hulumtim, menaxhim projektesh, ndërtim ekipi, komunikim dhe zhvillim strategjik. Përgjatë karrierës së tij profesionale, Shpati ka marrë pjesë në shumë trajnime, punëtori, konferenca, grupe punuese dhe aktivitete të ngjashme në lidhje me sigurinë, avokimin, ndërtimin e paqes dhe menaxhimin e projekteve.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kosova nuk ishte immune ndaj politizimit të pandemisë COVID-19. Ndërkohë që mbi vend mblihdeshin retë e krizës politike, vaksinimi i detyrueshëm, karantinat dhe masat mbrojtëse për menaxhimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 u kthyen në burim tensioni të lartë, dhe partitë politike, për avancimin e agjendave të tyre politike, shfrytëzuan frikën për shëndetin dhe pasigurinë ekonomike dhe të sigurisë, duke e bjerrë edhe më tej përgjigjen e publikut ndaj pandemisë.

Ky raport është një përpjekje për dokumentimin e rasteve të dezinformimit dhe polarizimit politik gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë, si dhe për gjurmimin e implikimeve të tyre në formësimin e qëndrimeve të publikut ndaj pandemisë dhe menaxhimit të pandemisë.

Përmes përdorimit të metodave të përziera të hulumtimit, të cilat përfshijnë punën studimore, monitorimin e mediave, pyetjet për grupet e fokusit dhe instrumentet e opinionit publik, raporti identifikon narrativat më të shpeshta të dezinformimit të hasur në domenin publik të Kosovës, studion mënyrën si ndërlidhen ato me narrativat globale dhe rajonale rreth pandemisë COVID-19, dhe heton mënyrën si u minuan përpjekjet për vaksinim masiv nga tronditja në themele e mjedisit politik të vendit, çka e rriti edhe më tej ngurrimin e publikut ndaj vaksinimit dhe çoi në numër rekord të vdekjeve.

Përmes shembujve në Kosovë, raporti vërteton gjetjet e kohëve të fundit të studiuesve që shqyrtojnë besimin e publikut tek qeveria dhe cënueshmërinë e atij vendi ndaj dezinformimit. Raporti tregon se besimi tek institucionet dhe politizimi i çështjeve të shëndetit publik janë dy faktorë që ndikojnë tek perceptimi i publikut rreth çështjeve të shëndetit publik, duke rezultuar në një mjedis me potencial më të lartë për depërtimin e dezinformimit.

Në këtë sens, përfundimi i raportit është se përpjekjet e mediave kryesore që të prodhonin dhe t'i ofronin publikut informacion të besueshëm rreth COVID-19, janë sfiduar nga prania e lajmeve të rreme dhe konspiracioneve për virusin dhe pandeminë, të shpërndara kryesisht përmes mediave digjitale, rrjeteve sociale dhe burimeve të paverifikuara online.

Prania e teorive konspirative, dezinformimit dhe lajmeve të rreme në rrjetet sociale në Kosovë, pati efekte të dëmshme tek perceptimi publik për pandeminë si kërcënim dhe pranimi i kufizimeve institucionale për parandalimin e pandemisë. Ky efekt u ndërlikua më tej nga paqëndrueshmëria politike e Kosovës, çka krijoi një terren pjellor për lajme të rreme dhe dezinformim rreth COVID-19. Institucionet, mediat dhe publiku nuk ishin të përgatitur për t'iu kundërvënë propagandës dhe dezinformimit që hidhnin dyshime rreth

ekzistencës së COVID-19, masave mbrojtëse kundër COVID-19 dhe vaksinimit.

Në tërësi, ky raport është një paralajmërim për institucionet dhe publikun e Kosovës, dhe shërben si thirrje urgjente për shqyrtimin e përpjekjeve për komunikim strategjik teksa bëhemi gati për krizat e ardhshme kombëtare.

HYRJE

- COVID-19: Peisazhi mediatik, narrativat dhe përkufizimet globale dhe lokale
- PËRKUFIZIMET: Dezinformimi, keqinformimi, teoritë konspirative dhe lidhja e tyre me informacionin e rremë
- Narrativat mbizotëruese globale rreth COVID-19
- Narrativat mbizotëruese rajonale rreth COVID-19



COVID-19: Peisazhi mediatik, narrativat dhe përkufizimet globale dhe lokale

Në Kosovë, pandemia COVID-19 filloi me lajme të rreme.¹ Me rastin e parë të infektimit me koronavirus të shënuar në fund të marsit 2020, Kosova i menaxhoi më mirë se fqinjët dy vitet e para të pandemisë, kryesisht falë vendimit të qeverisë për t'u mbështetur në vaksinat Pfizer dhe fushatës energjike për vaksinim në mesin e vitit 2021. Megjithatë, pandemia ekspozoi brishtësinë institucionale, mungesën e legjislacionit, si dhe dobësitë e komunikimit strategjik që duken veçanërisht të dëmshme për aftësinë e Kosovës për ta menaxhuar një krizë të shëndetit publik.

Kosova zor se do ishte unike në luftimin e këtyre faktorëve kontribues në përgjigjen e përzier të vendit ndaj pandemisë COVID-19, por ky menaxhim i një krize globale ishte gjithashtu testi i parë madhor që i bëhej në ekzistencën e saj 13 vjeçare si shtet. Duke qenë se brishtësia institucionale dhe përgjigja e përzier emergjente janë shtjelluar në detaje diku tjetër,² ky raport është një përpjekje për dokumentimin e dezinformimit gjatë COVID-19 në Kosovë dhe për të kuptuar implikimet e tij në formësimin e qëndrimeve të publikut ndaj pandemisë. Teksa bota ndeshej me efektet sociale dhe ekonomike të pandemisë COVID-19, pandemia e parë globale në kohën e revolucionit digjital, shtetet u detyruan të përballen me pasojat e një beteje tjetër me përmasa pandemike – informacioni i rremë që në epokën e rrjeteve sociale, cikleve 24 orëshe të lajmeve dhe ankthit për mbijetesë, i ka zbehur dallimet mes fakteve dhe trillimeve.

Përpjekjet e qeverive dhe komuniteteve mjekësore për reagim ndaj pasojave të pandemisë shpesh u penguan ose u ndërlikuan nga dezinformimi dhe keqinformimi që i trazuan dhe polarizuan shoqëritë edhe më tej dhe minuan përgjigjen ndaj COVID-19.

Trendi i informacionit që çonte në përfundime të gabuara, si në mënyrë të qëllimshme ashtu edhe të rastësishme, dhe dëmi që shkaktoi dezinformimi në menaxhimin e pandemisë duke i ndarë shoqëritë në mbarë botën në baza ideologjike, e shtynë Organizatën Botërore të Shëndetësisë të definojë termin "infodemi" për të përshkruar fenomenin e "tepricës së informacionit" që "minon përgjigjen e shëndetësisë publike dhe avancojnë agjenda alternative të grupeve ose individëve".³

1 "Ekskluzive: Shenohet rasti i pare i infektuar me koronavirus ne Kosove," Arberesh.info, 11 mars 2020 <https://www.arberesh.info/arberesh-story/ekskluzive-shenohet-rasti-i-pare-i-infektuar-me-koronavirus-ne-kosove/>

2 Teuta Avdimetaj, Shpat Balaj dhe Plator Avdiu, "Të zënë ngushtë: Sfidat e Kosovës në përballjen me pandeminë COVID-19", Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 27 dhjetor 2020 <https://qkss.org/en/publikimet/te-zene-ngushte-sfidat-e-kosoves-ne-perballjen-me-pandemine-covid-19/>

3 Organizata Botërore e Shëndetësisë, "Menaxhimi i infodemisë COVID-19: Promovimi i sjelljeve të shëndetshme

Me zhvillimin e pandemisë, OBSH vuri re se efekti i fushatave të informacionit keqdashës kishte ndikim të drejtpërdrejtë në kundërshtimet prej shoqërisë dhe mosrespektimin e metodave të sigurisë të promovuara gjatë pandemisë. Mbajtja e maskave, distancimi dhe vaksinimi, masat në të cilat u mbështet komuniteti mjekësor për të frenuar përhapjen e virusit dhe përfundimisht për t'i dhënë fund pandemisë globale, u kthyen në simbole të një beteje ideologjike globale.

Pas këtyre pasojave të menjëhershme të "infodemisë" së dezinformimit dhe keqinformimit në menaxhimin e pandemisë dhe frenimin e vdekjeve të shkaktuara prej saj, OBSH-ja paralajmëroi se vinin sfidat afatgjata ndaj standardeve demokratike dhe kohezionit social që do të shkaktonte ky fenomen.

Gjatë rrjedhës së betejës së vazhdueshme me COVID-19, "infodemia" jo vetëm që kushtoi jetë, por edhe minoi kontratën sociale që rregullon marrëdhëniet mes qeverive dhe zgjedhësve në pjesën më të madhe të botës demokratike.

Bashkimi Evropian i klasifikoi narrativat e rreme si fushata të qëllimshme dezinformuese të përhapura nga aktorë që shkonin nga lojtarë të huaj si Rusia dhe Kina në kërkim të përfitimeve politike, deri te mashtrues në kërkim të përfitimeve ekonomike individuale përmes klikimeve mashtruese, krimet kibernetik dhe mashtrimeve online, dhe dezinformimit.⁴ BE-ja paralajmëroi në mënyrë specifike se "aktorë të huaj dhe disa vende të treta, veçanërisht Rusia dhe Kina, janë përfshirë në operacione ndikimi të targetuar dhe fushata dezinformimi në BE, në fqinjësinë e saj, dhe në mbarë botën".⁵

Me rrjetet sociale si përforcuesin më të fuqishëm dhe shtetet e shoqëritë të papërgatitura për t'iu përgjigjur dezinformimit dhe keqinformimit të kësaj shkalle, informacioni i rremë depërtoi nëpër shtëpitë e banesat e publikut në një kohë izolimi, karantine dhe pasigurie mbi ndikimin në shëndet. Reagimi ndaj pandemisë u kthye në flamur ideologjik, teksa elitat politike, veçanërisht në vendet demokratike ku publiku ndikohet prej pikëpamjeve të elitave, zhvilluan betejat e tyre për pushtet politik në përpjekje të mobilizojnë bazën e mbështetësve të tyre, duke përcaktuar frymën e reagimit të fragmentuar kombëtar.⁶

Përhapja e SARS-COV 2 dhe variantet e tij të ndryshme kanë qenë subjekt i lajmeve të rreme, dezinformimit, teorive konspirative të promovuara në rrjetet

dhe zbutja e dëmit nga keqinformimi dhe dezinformimi," OBSH, 23 shtator 2020

4 Komisioni Evropian, "Trajtimi i dezinformimit për koronavirusin", KE, 10 qershor 2020 https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/corona_fighting_disinformation_0.pdf

5 Po aty.

6 Green, Jon et al. "Konsensusi i pakapshëm: polarizimi në komunikimin elitar për pandeminë COVID-19." Science advances vol. 6,28 eabc2717. 10 korrik 2020, doi:10.1126/sciadv.abc2717

sociale dhe mediat kryesore. Mungesa e menaxhimit të informacionit të rremë dhe lajmeve të rreme i ka sfiduar komunitetet, qytetarët dhe institucionet në menaxhimin e pandemisë dhe uljen e përhapjes së virusit. Përhapja e dezinformimit dhe teorive konspirative për virusin COVID-19 minoi besimin e qytetarëve tek qeveritë dhe masat e marra prej tyre për parandalimin e pandemisë.

Globalizimi i informacionit dhe burimet e shumta alternative të lajmeve i kanë bërë joefikase përpjekjet për luftimin e informacionit të rremë dhe lajmeve të rreme në lidhje me pandeminë COVID-19. Raporti arrin në përfundimin se përkundër përpjekjeve të tyre për të komunikuar çdo ditë me publikun, institucionet e Kosovës nuk arritën të krijojnë një sistem komunikimi për trajtimin e lajmeve të rreme dhe për menaxhimin e një përgjigjeje efektive kombëtare për frenimin e përhapjes së informacionit të rremë – si dezinformim ashtu edhe keqinformim – rreth virusit dhe pasojave të tij.

Në pjesën vijuese, raporti i definon shkurtimisht termat për dezinformim, keqinformim, teoritë konspirative dhe informacionin e rremë, për të bërë dallime mes katër kategorive dhe për të sqaruar dhe kontekstualizuar përdorimin e tyre në këtë raport. Më pas jepet një përmbledhje e narrativave mbizotëruese globale dhe rajonale mbi pandeminë COVID-19. Raporti gjithashtu identifikon narrativat lokale, si dhe gjurmon burimet e dezinformimit dhe keqinformimit për COVID-19 në Kosovë. Veç kësaj, raporti diskuton shfrytëzimin politik të pandemisë nga akterë të ndryshëm politikë dhe marrëdhëniet mes besimit të publikut tek qeveria, besimit tek reaguesit e parë të vendit, elitat politike, dhe perceptimit të publikut për mënyrën si e menaxhoi qeveria pandeminë, duke përfshirë trajtimin nga qeveria të dezinformimit.

Raporti mbështetet në një metodologji të metodave të përziera, duke nisur me punën studimore rreth zhvillimit të trendeve dhe narrativave, përkufizimeve dhe praktikave globale dhe rajonale, e duke vijuar me monitorimin e mediave kryesore, platformave të rrjeteve sociale si Facebook, Twitter, TikTok, Telegram dhe Instagram, dhe të influencuesve kyç, për identifikimin e narrativave vendore të COVID-19. Në këtë drejtim, u zhvillua një bazë e gjerë e të dhënave e materialeve që përmbanin informacion të rremë me burime nga rrjetet sociale dhe mediat online në gjuhën shqipe dhe serbe dhe që përfshin më shumë se 800 burime nga platforma të ndryshme të rrjeteve sociale ose agjenci të lajmeve online. Pasi u identifikuan, këto narrativa më pas u krahasuan dhe u testuan me gjetjet nga tre grupe të fokusit në Prishtinë për të distiluar teoritë më të shpeshta konspirative rreth COVID-19 që qarkullojnë në Kosovë. Dy grupe të fokusit përfshinin një grup të të anketuarve që pasqyronin diversitetin demografik dhe socio-ekonomik të Kosovës. Grupi i dytë i fokusit përbëhej nga përfaqësues të institucioneve të Kosovës, kryesisht nëpunës

civilë, në përpjekje për të kapur perceptimet, përvojat dhe njohuritë e tyre rreth përgjigjes së qeverisë ndaj COVID-19 dhe dezinformimit.⁷

Në pjesën e dytë, raporti shqyrton edhe legjislacionin e Kosovës për luftimin e dezinformimit përmes kornizës ligjore në dispozicion. Përmes një krahasimi mes shkallës së infektiveve dhe asaj të vaksinimit kundrejt disa rasteve kyçe të politizimit të masave kundër COVID-19, raporti gjithashtu tregon ndikimin e polarizimit politik gjatë një krize të shëndetit publik. Për fund, raporti integron gjetjet kuantitative të anketës të Barometrit të Sigurisë të Ballkanit Perëndimor e zhvilluar nga QKSS, i cili në vitin 2022 përfshiu pyetje specifike në lidhje me perceptimet e qytetarëve për përgjigjen e qeverisë ndaj COVID-19, dezinformimin dhe perceptimet e tyre për ndikimin e tij, si dhe mati qëndrimet e tyre ndaj procesit të vaksinimit.

Pas vlerësimit kritik të kornizës kombëtare të Kosovës në vitin 2020 nga QKSS-ja, qëllimi i përgjithshëm i këtij raporti të QKSS-së është të identifikojë manifestimin vendor të dezinformimit dhe të vlerësojë në mënyrë kritike ndikimin që besimit në institucione ka në menaxhimin e pandemisë. Në përpjekje të identifikojë dobësitë dhe mangësitë e përgjigjes së përgjithshme ndaj pandemisë, raporti gjithashtu shqyrton efektin e dezinformimit në reagimin e publikut ndaj pandemisë përmes një analize të shkurtër të kufijve ligjorë dhe pritjeve të publikut të Kosovës nga përfaqësuesit e vet të zgjedhur.

PËRKUFIZIMET: Dezinformimi, keqinformimi, teoritë konspirative dhe lidhja e tyre me informacionin e rremë

Dezinformimi dhe keqinformimi kanë qenë temë interesi dhe studimi prej studiuesve që hulumtojnë mediat dhe fenomenet sociale dhe ndërveprimin e tyre në formësimin e opinionit dhe qëndrimeve publike. Edhe pse janë tipare të përcaktuara dhe të studiuara mirë të kohës sonë dhe kanë ekzistuar para COVID-19, për qëllimin e këtij raporti, autorët mbështeten në përkufizimet e dhëna nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO) për të mbërthyer natyrën e këtyre dy kategorive, të përbashkëtat dhe divergjencat e tyre, si dhe lidhjen e tyre me informacionin e rremë, metodat e përdorura për shpërndarjen e tij, dhe qëllimin e synuar siç u

7 Grupi i parë i fokusit u mbajt në Prishtinë më 27 tetor 2021, me gjithsej 11 pjesëmarrës. Pjesëmarrësit përfshinin përfaqësues të institucioneve kyçe të sigurisë në Kosovë duke përfshirë Forcën e Sigurisë së Kosovës, Ministrinë e Mbrojtjes, Policinë e Kosovës, Inspektoratin Policor të Kosovës, Agjencinë Kosovare të Inteligjencës, Doganën e Kosovës, Agjencinë e Informimit dhe Privatësisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Prokurorinë e Shtetit. Grupi i dytë i fokusit u organizua më 8 shkurt 2022, në Prishtinë, me gjithsej 11 pjesëmarrës. Pjesëmarrësit përfshinin pesë të rinj të moshës 16-21 vjeç dhe të moshuar të moshës 65-75 vjeç. Grupi i tretë i fokusit u organizua më 18 mars 2022, në Prishtinë, me tetë studentë nga universitetet publike dhe private të Kosovës.

përdor gjatë krizës globale të COVID-19.

Sipas ekspertëve të UNESCO-s, të dyja kategoritë bazohen në informacione të rreme, por ajo që i veçon është qëllimi dhe përdorimi i krijuesit të tyre. UNESCO e përkufizon dezinformimin si “informacion që është i rremë dhe është krijuar qëllimisht për të dëmtuar një person, grup shoqëror, organizatë ose shtet”. Keqinformimi, nga ana tjetër, përkufizohet si “informacion që është i rremë, por jo i krijuar me qëllimin për të shkaktuar dëm”.⁸ Sidoqoftë, të dyja format kanë një ndikim po aq keqdashës në mirëqenien e konsumatorëve të tyre.⁹

Teoritë konspirative përkufizohen si të besuarit tek manipulimi dhe orkestrimi i projektuar i ngjarjeve botërore nga grupe ose individë të fuqishëm.¹⁰ Teksa teoritë konspirative mund të bien në fushën e dezinformimit, ekspertët i veçojnë kryesisht sipas qëllimit të autorit të tyre. Siç u diskutua më lart, dezinformimi është informacion i rremë që përdoret qëllimisht për të shkaktuar dëm, ndërsa teoritë konspirative janë bindje të thella të individëve që i përhapin. Megjithatë, kohët e fundit, teoritë konspirative janë avancuar edhe për përfitime, por edhe për të radikalizuar mbështetësit dhe për të mobilizuar ndjekësit.

Përveç këtyre tri kategorive të dobishme për të diferencuar informacionin e rremë në qarkullim gjatë COVID-19, platforma e BE-së e ngarkuar me demaskimin e dezinformimit përdori edhe një taksonomi të sfidave informative sipas teorive të COVID-19 në BE duke përfshirë edhe termat “ndërhyrja e huaj” dhe “operacionet e ndikimit” për ta ekspozuar më tej natyrën e qëllimshme të përhapjes së dezinformimit. Të dyja kategoritë nënkuptojnë koordinim dhe presupozojnë një përpjekje të qëllimshme nga një aktor – një organizatë ose një shtet i huaj – për ta përdorur dezinformimin për të shkaktuar përçarje në mjedisin e targetuar.¹¹

8 UNESCO, Gazetaria, lajmet e rreme dhe dezinformimi: Doracak për Edukim dhe Trajnim në Gazetari, 2018 https://en.unesco.org/sites/default/files/journalism_fake_news_disinformation_print_friendly_0.pdf

9 Posetti, Julie dhe Kalina Bontcheva, “Dezinfodemia: deshifrimi i dezinformimit për COVID-19”, UNESCO, qasur më 25 mars 2022 https://en.unesco.org/sites/default/files/disinfodemic_deciphering_covid19_disinformation.pdf

10 Michael Butter et al, “Udhëzues për teoritë konspirative”, Bashkëpunimi Evropian në Shkencë dhe Teknologji, mars 2020 https://conspiracytheories.eu/_wp-content/uploads/2020/03/COMPACT_Guide-2.pdf

11 BE-ja kundër Dezinformimit, Përditësimi i Raportit të Posaçëm të EEAS: Vlerësim i shkurtër i narrativave dhe dezinformimit rreth pandemisë COVID-19”, 1 prill 2020 <https://euvsdisinfo.eu/eeas-special-report-update-short-assessment-of-narratives-and-disinformation-around-the-covid-19-pandemic/>

Narrativat mbizotëruese globale rreth COVID-19

Studiuesit që e studiuuan në kohë reale përhapjen e dezinformimit në fillimin e pandemisë COVID-19 në fillim të vitit 2020 dhe e gjurmuan deri kur pandemia hyri në vitin e tretë, zbuluan se narrativat e rreme iu nënshtruan një procesi transformimi dhe përshtatjeje të vazhdueshme,¹² por që pavarësisht rrjeteve globale të shpërndarjes së informacionit dhe natyrës globale të pandemisë, ka shumë heterogjenitet në manifestimin e tyre.¹³

Në fillim, kur shpërthimi ishte kryesisht në Kinë, dezinformimi u përqendruan në origjinën e virusit, por teksa virusi u përhap në Evropë dhe SHBA, narrativat u bënë lokale në natyrë dhe luajtën me frikën dhe pasiguritë e brendshme.¹⁴

Bazuar në gjurmimin dhe monitorimin e shembujve në Francë, Spanjë dhe Itali, studiues nga platforma e BE-së që studiojnë modelet e dezinformimit, i tipizuan narrativat kryesore në pesë grupe temash të veçanta. Narrativat shkonin nga ato që përhapnin frikë për shëndetin për të shkaktuar ndjenja paniku në publik e deri te teoritë konspirative që fajin për virusin ia vinin industrisë së madhe farmaceutike ose një arme biologjike në garën për sundim të fuqive të mëdha, ose themeluesit të Microsoft dhe filantropit Bill Gates. Grupi tjetër i narrativave u bazua në kura të rreme, ankthet e karantinës dhe polarizimin politik, veçanërisht në mbjelljen dhe shfrytëzimin e ndasive brenda dhe mes vendeve evropiane, duke përfshirë storjet që ndërthurin COVID-19 dhe migrimin,¹⁵ një temë shumë përçarëse në Evropë dhe që i ka paraprirë pandemisë.

Në mënyrë të ngjashme, UNESCO identifikoi nëntë tema kryesore të dezinformimit në lidhje me COVID-19 që minuan përgjigjen ndaj pandemisë, me shumicën prej tyre që shfrytëzonin paragjykime raciste dhe ksenofobe.¹⁶ Ato përfshinin narrativa të rreme mbi origjinën e virusit, statistika çoroditëse mbi shifrat e pandemisë, ndikimin e saj ekonomik, bjerrjen e besimit në burime informacioni dhe komentues/ekspertë të besueshëm, trajtim dhe kura të rreme

12 Raquel Miguel Serrano et al. "Dezinformimi për COVID-19: narrativat, trendet dhe strategjitë në Evropë", EU Disinfo Lab, 2 prill 2020 <https://www.disinfo.eu/publications/covid-19-disinformation-narratives-trends-and-strategies-in-europe/>

13 Samikshya Siwakoti, Kanya Yadav, Isra Thange, Nicola Bariletto, Luca Zanotti, Alaa Ghoneim, dhe Jacob N. Shapiro. Keqinformimi i lokalizuar në një pandemi globale: raport mbi narrativat rreth COVID-19 nëpër botë. Studime Empirike të Konfliktit, Universiteti Princeton, faqet 1-68, mars 2021. URL <https://esoc.princeton.edu/publications/localized-misinformation-global-pandemic-report-covid-19-narratives-around-world>

14 Raquel Miguel Serrano et al. "Dezinformimi për COVID-19: narrativat, trendet dhe strategjitë në Evropë", EU Disinfo Lab, 2 prill 2020 https://www.disinfo.eu/publications/covid-19-disinformation-narratives-trends-and-strategies-in-europe

15 Po aty

16 Posetti, Julie dhe Bontcheva, Kalina. "Dezinfodemia: deshifrimi i dezinformimit për COVID-19", UNESCO, 2020 <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000374416> fq. 5

për COVID-19, efektet mjedisore të pandemisë, politizim, përfitime mashtruese dhe storje të rreme për betejën e të famshmëve me infeksionin.¹⁷

Një raport krahasues i vendeve nga Studimet Empirike të Konfliktit zbuloi se gjatë COVID-19, narrativat e lokalizuara dolën më të forta se ato globale që ndryshonin sipas rajoneve. Në Evropë, shumica e narrativave u fokusuan në "thashetheme të rreme" rreth reagimit nga qeveria dhe jashtë qeverisë ndaj pandemisë, natyrën e virusit dhe konspiracione kundër vaksinimit.¹⁸

Përveç teorive të përhapura konspirative që e lidhnin origjinën e virusit me rrjetin 5G ose Bill Gates apo paragjytimeve antisemite,¹⁹ nga Rusia u shpërnda dezinformim i motivuar politikisht kundër Bashkimit Evropian. Një pjesë e madhe e narrativave negative rreth COVID-19 u shfrytëzuan për ta portretizuar BE-në si joefektive dhe jofunksionale, kurse arritjet e BE-së përmes reagimit të unifikuar si qesharake.²⁰ Për dallim nga qëllimet strategjike të Rusisë për ta minuar BE-në dhe për të dobësuar unitetin e bllokut teksa Rusia lëviz drejt rivendosjes së pranisë së saj në Evropën Lindore dhe Ballkanin Perëndimor përmes dezinformimit të targetuar, Kina e pa pandeminë si një mundësi për ta ringritur imazhin e saj të dëmtuar nga origjina e koronavirusit dhe për ta projektuar veten si një superfuqi dashamirëse. Narrativat kryesore të Kinës u përpoqën ta projektonin vendin - të sunduar nga një regjim autoritar - si një model i ndryshëm nga përgjigja kaotike e vendeve demokratike ndaj pandemisë, dhe si një aktor humanitar që u vjen në ndihmë shteteve të tjera evropiane në vështirësi dhe të braktisura nga BE-ja.²¹

Në përgjithësi, shumica e pretendimeve të rreme kishin të bënin me veprimet ose politikat e qeverive dhe organeve ndërkombëtare, si OBSH dhe agjenci të tjera të OKB-së.²² Rreth 88% e pretendimeve të rreme të studiuara janë shfaqur në platforma të rrjeteve sociale, pastaj televizione, gazeta dhe ueb faqe.²³

17 Po aty

18 Siwakoti, S. et al, "Keqinformimi i lokalizuar në një pandemi globale: raport mbi narrativat rreth COVID-19 nëpër botë", Studime Empirike të Konfliktit, Universiteti Princeton, 25 mars 2021 <https://drive.google.com/file/d/1LqoK1IK4ufIQ3OisLVPBT99ikAD87wfX/view>

19 Weiner, Alyssa, "Trendet globale në teoritë konspirative që lidhin hebrenjtë me koronavirusin", Këshilli Hebre i Amerikës

20 Për më shumë, shihni Disinfo Database të platformës EUvsDisinfo, e cila dokumenton rastet e dezinformimit që targeton përgjigjen e BE-së ndaj pandemisë <https://euvsdisinfo.eu/disinformation-cases/?text=eu%20coronavirus&date=&fbclid=IwAR2J6FG5pJBzzJhdIM57-yZS8CpgPo3q-AMkvjzlazwBZhDkUli5CLKRVxy>, qasur më 24 mars 2022

21 Cook, Sarah, "Propaganda e Pekinit për koronavirusin ka caqe të jashtme të dhe të brendshme", Freedom House, 20 prill 2020 <https://freedomhouse.org/article/beijings-coronavirus-propaganda-has-both-foreign-and-domestic-targets>

22 Simon, Felix et al, "Llojet, burimet dhe pretendimet e keqinformimit rreth COVID-19", Instituti Reuters dhe Universiteti i Oksfordit, 7 prill 2020 <https://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/types-sources-and-claims-covid-19-misinformation#footnote-01>

23 Po aty.

Narrativat mbizotëruese rajonale rreth COVID-19

Gjatë gjithë pandemisë, trendet në Ballkanin Perëndimor pasqyruan ato që qarkullonin gjatë në Evropë dhe në mbarë botën. Teoritë konspirative që e përshkruanin virusin COVID-19 si armë në garën mes fuqive të mëdha ishin të shumta në mbarë rajonin dhe kishin të njëjtin efekt në mbjelljen e dyshimit ndaj thirrjeve për vaksinim dhe masave për menaxhimin e pandemisë. Dezinformimi dhe keqinformimi i formave të ndryshme u duk se formëson reagimin e publikut ndaj pandemisë, sollën trysni të paprecedentë mbi sektorët e rrënuar të shëndetësisë, si dhe shtuan pasigurinë dhe konfuzionin politik. Gjatë kësaj kohe, studiuesit dhe kontrolluesit e fakteve në Ballkanin Perëndimor vërejtën shfaqjen e një modeli gjeopolitik mes audiencës së rajonit, me publikun të hapur ndaj teorive të veçanta të bazuara në orientimin dhe përkatësinë e tyre ideologjike,²⁴ çka i polarizoi dhe armiqësoi më tej shoqëritë në fjalë.

Në mbarë Ballkanin, teoritë më të njohura konspirative silleshin rreth origjinës së virusit. Shumica dërrmuese e publikut në Shqipëri, Kosovë, Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Maqedoni të Veriut besonin se virusi COVID-19 ishte prodhuar në një laborator kinez ose ishte vepër e industrisë farmaceutike. Teori të tjera të njohura konspirative përfshinin injeksione me mikroçip për kontrollin e popullsisë nga Bill Gates dhe rrjetin 5G.²⁵

Përveç këtyre narrativave të rreme, Ballkani Perëndimor ishte cak i fushatave të qëllimshme dezinformuese që ndikuan në marrëdhëniet e rajonit me BE-në dhe nganjëherë i përkeqësuan marrëdhëniet tashmë të tensionuara mes vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo seri e narrativave mori karakter lokal dhe u kthye në mjet për larje hesapesh mes elitave politike, kurse rekomandimet e ekspertëve ranë viktimë e grindjeve të brendshme politike, duke dobësuar më tej besimin e publikut tek institucionet dhe këshillat e komunitetit mjekësor. Për më tepër, këto narrativa të përhapura kryesisht nga burime pro-ruse, synonin ta zgjeronin hendekun mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, shpesh duke e paraqitur BE-në si një palë vetanake që e braktisi rajonin në valë të luftës për ta frenuar pandeminë me burimet e veta të kufizuara.²⁶ Teksa pandemia hyri në vitin e dytë dhe vaksinimi u bë gjerësisht i disponueshëm, kanalet e propagandës ruse dhe kineze dhe përfaqësuesit e tyre në rajon, i rikalibruan taktikat e dezinformimit për të sulmuar vaksinat e prodhuara nga perëndimi, AstraZeneca, Pfizer dhe Moderna, dhe për të përhapur efektet e pretenduara

24 Bieber, Florian et al. "Virusi i dyshimtë: Konspiracionet dhe COVID-19 në Ballkan", Grupi Këshillimor i Politikave të Ballkanit në Evropë, korrik 2021 <https://biepag.eu/wp-content/uploads/2021/07/Conspiracies-and-COVID19-in-the-Balkan-English-2.pdf>

25 Po aty.

26 BE-ja kundër Dezinformimit, Përditësimi i Raportit të Posaçëm të EEAS: Vlerësim i shkurtër i narrativave dhe dezinformimit rreth pandemisë COVID-19", 1 prill 2020 <https://euvsdisinfo.eu/eeas-special-report-update-short-assessment-of-narratives-and-disinformation-around-the-covid-19-pandemic/>

negative të vaksinave në përpjekje të ndërtojnë një narrativë pozitive për vaksinat e tyre.²⁷

Në nivel rajonal, mjetet kryesore të përdorura për përhapjen e dezinformimit dhe keqinformimit në Ballkanin Perëndimor ishin platformat e rrjeteve sociale, përkatësisht Facebook dhe aplikacionet e njohura të mesazheve si Telegram, Viber dhe WhatsApp, por skepticizmi ndaj vaksinave e gjeti rrugën të hyjë edhe në mediat tradicionale dhe kryesore,²⁸ duke kontribuar në ngurrimin ndaj vaksinimit dhe duke ndikuar në shkallën e vaksinimit.

27 BE-ja kundër Dezinformimit, Përditësimi i Raportit të Posaçëm të EEAS: Vlerësim i shkurtër i narrativave dhe dezinformimit rreth pandemisë COVID-19", 28 prill 2020 <https://euvsdisinfo.eu/eeas-special-report-update-short-assessment-of-narratives-and-disinformation-around-the-covid-19-pandemic-update-december-2020-april-2021/>

28 Po aty

POLITIZIMI I OPANDEMISË COVID-19 NË KOSOVË

Kosova nuk ishte immune ndaj politizimit të pandemisë COVID-19. Ndërkohë që mbi vend mblihdeshin retë e krizës politike pas dorëheqjeve të presidentit të vendit Hashim Thaçi dhe kryetarit të Kuvendit Kadri Veseli për t'u përballur me akuzat për krime lufte nga Gjykata Speciale në vitin 2020 dhe rindarjes së pushtetit, vaksinimi i detyrueshëm, karantinat dhe masat mbrojtëse për menaxhimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 u kthyen në burim tensioni të lartë, dhe partitë politike, për avancimin e agjendave të tyre politike, shfrytëzuan frikën për shëndetin dhe pasiguritë ekonomike dhe të sigurisë, duke e bjerrë edhe më tej përgjigjen e publikut ndaj pandemisë.

Në fund të marsit 2020, kur në Kosovë filluan të shfaqeshin rastet e para të COVID-19, rivalët e kahershëm politikë, presidenti i atëhershëm i Kosovës Hashim Thaçi dhe kryeministri i vendit Albin Kurti, ishin të mbërthyer në një betejë për vendosjen e kufizimeve për frenimin e pandemisë. Duke i quajtur masat si "jokushtetuese", Thaçi u bëri thirrje qytetarëve të Kosovës që t'i shpërfillin kufizimet e lëvizjes të vendosura nga qeveria e Kurtit dhe e paralajmëroi policinë që të mos t'i respektojë urdhrat e qeverisë.²⁹

Debatet e tjera që mund të kenë kontribuar në ngurrimin ndaj vaksinimit në Kosovë dhe e kanë dobësuar më tej besimin në institucionet e Kosovës, ishin të lidhura me debatin për blerjet e vaksinave ndërmjet qeverisë në ikje dhe asaj në ardhje, dhe ndërsa palët shkëmbenin akuza për praktika korruptive dhe joefikasitet në kontraktimin e vaksinave, Kosova mbeti prapa të gjithë rajonit në shkallën e vaksinimit.³⁰ Një rast i tillë ishte vendimi i Kurtit për të refuzuar ofertën e Shqipërisë për vaksinat kineze në Kosovë në vitin 2021, një vendim që qeveria e argumentoi politikisht dhe jo për shkak të shqetësimeve të shëndetit publik.³¹

Një tjetër rast i tillë ishte pretendimi i një deputeti kosovar, Bekim Haxhiut, se qeveria e Kosovës pranoi 130,000 vakcina Astra Zeneca nga Norvegjia pas vendimit të atij vendi për t'i larguar nga përdorimi vaksinat vetëm disa

29 Bekim Bislimi dhe Mimoza Sadiku, "Presidenti Thaci kundërshton masat e qeverise per kufizimin e levizjes se lire," Radio Evropa e Lire, 23 mars 2020 <https://www.evropaelire.org/a/hashim-thaci-masat-qeveria-kufizimi-i-levizjes-/30505139.html>

30 "Publikohen dokumente qe tregojne mos-nenshkrimin e kontrates nga Arben Vitia per furnizimin me 500 mije doza te vaksinës Pfizer," Telegrafi, 16 prill 2021 <https://telegrafi.com/publikohen-dokumentet-qe-tregojne-mosnenshkrimin-e-kontrates-nga-arben-vitia-per-furnizimin-500-mije-doza-vaksinash-pfizer/>

31 Më 5 prill 2021, Kurti deklaroi se Kosova do ta refuzonte ofertën e Shqipërisë për vakcina kineze për Kosovën dhe do të pranonte vetëm vakcina nga vendet që e kanë njohur pavarësinë e vendit, por nuk ofroi argumente mjekësore për preferencën e tij për vaksinat e patentuara perëndimore, pavarësisht disponueshmërisë së të dhënave për efikasitetin e ulët të vaksinave të prodhuara nga Kina dhe Rusia. Për më shumë shih "Kosova nuk pranon vaksinat kineze nga Shqipëria, Kurti: Do marrim vetem nga shtete qe na kane njohur," 5 prill 2021 <https://abcnews.al/kosova-nuk-pranon-vaksinat-kineze-nga-shqiperia-kurti-do-marrim-vetem-nga-shtete-qe-na-kane-njohur/>

ditë para skadimit të tyre, çka çoi në refuzimin e tyre nga publiku i Kosovës në kulmin e valës së dytë të pandemisë në 2021,³² rritja më vdekjeprurëse në trajektoren e COVID-19 në Kosovë.

Në mënyrë të ngjashme, gjatë verës së vitit 2021, teksa Kosova regjistroi numrin më të lartë të vdekjeve nga varianti Delta i COVID-19 pas vendimit të qeverisë për t'i hequr të gjitha masat, duke përfshirë dëshminë e një testi negativ PCR dhe vërtetimin e vaksinimit për ata që hynin në Kosovë nga jashtë, rivalët e Kurtit e fajësuan qeverinë e tij për paaftësinë që ta mobilizojë publikun për vaksinim³³ dhe ministrat e tij – përkatësisht ministrin e shëndetësisë – për shkeljen e kufizimeve ndaj COVID-19 dhe minimin e bindjes së publikut ndaj rregullave të pandemisë.³⁴

Teksa ky raport nuk mund të përcaktojë marrëdhënie të drejtpërdrejtë shkak-pasojë mes polarizimit politik dhe politizimit të masave kundër COVID-19 dhe shkallës së infektimit, shkallës së vaksinimit dhe shkallës së vdekjeve, përmes shembujve të mësipërm mund të konkludohet se hedhja e akuzave dhe kundërakuzave dhe mungesa e mesazhit konsistent dhe të unifikuar, shoqëruar me mungesën e strategjisë për komunikim strategjik për kundërveprim ndaj informacioneve të rreme (dezinformimi, keqinformimi dhe teoritë konspirative), u shfaqën si faktorë kontribuues në rezultatet e përziera të Kosovës në menaxhimin e pandemisë.

Deri në maj të vitit 2022, sipas statistikave zyrtare, Kosova kishte 228,000 persona të raportuar si të infektuar nga COVID-19 dhe 3,139 vdekje (ose 1.38 për qind e të gjitha infektimeve kanë rezultuar në vdekje), me periudha të forta piku në korrik-gusht 2020, nëntor 2020 deri në maj 2021, dhe gusht-shtator 2021.

32 “Bekim Haxhiu: Vaksinave Astra Zeneca te dhuruara nga Norvegjia u skadon afati pas shtate ditësh,” GazetaBlic.com, 3 korrik 2021 <https://gazetablic.com/bekim-haxhiu-vaksinat-astra-zeneca-te-dhuruara-nga-norvegjia-u-skadon-afati-pas-shtate-ditesh/>


33 “Haradinaj: Kur u shfaq variant Delta i COVID-19, Kurti shetitej ne Greqi e France,” Gazeta Express, 2 shtator 2021 <https://www.gazetaexpress.com/haradinaj-kur-u-shfaq-varianti-delta-i-covid-19-kurti-shetitej-ne-greqi-e-france/>

34 “Flet Arben Vitia pasi u pa duke vallezuar ne nje dasem, nen ritmin e kenges se Afrim Muciqit,” Gazeta Express, 9 gusht 2021 <https://www.gazetaexpress.com/flet-arben-vitia-pasi-u-pa-duke-vallezuar-ne-nje-dasme-nen-ritmin-e-kenges-se-afrim-muciqit/>

Figura 1

Pasqyra e të gjitha vdekjeve nga COVID-19 në Kosovë. Përditësuar për herë të fundit më 16 maj 2022. Burimi:

Të dhënat për COVID-19 të JHU CSSE



Teksa valët e COVID-19 pasqyrojnë trendet e infektimit dhe shkallët e vdekshmërisë para vaksinimit në botën në zhvillim, tipari më i spikatur në statistikat e Kosovës për COVID-19 janë shkalla e vdekjeve në gusht dhe shtator 2021.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës, nga 5 gushti deri më 1 dhjetor janë 1,435 kosovarë të vdekur si pasojë e COVID-19,³⁵ përkundër disponueshmërisë së vaksinave në Kosovë.³⁶ Në atë kohë, qeveria e Kosovës raportoi se në maj kishte blerë me sukses 1 milion vakcina Pfizer. Autoritetet thanë se 622,000 vakcina u dorëzuan në Kosovë në korrik dhe gusht. Megjithatë, deri në fund të gushtit, shkalla mesatare ditore e vdekjeve në Kosovë arriti në 20–30 vdekje në ditë dhe zyrtarët e shëndetësisë publike konstatuan se 89% e vdekjeve nga 1 gushti deri më 1 dhjetor 2021 në Kosovë ishin persona të pavaksinuar.³⁷

35 Per kater muaj, 89% e te vdekurve nga COVID-19 ne Kosove ishin te pavaksinuar,” Koha Ditore, 13 dhjetor 2021 <https://www.koha.net/arberi/301104/per-kater-muaj-89-e-vdekjeve-nga-covid-19-ishin-te-pavaksinuar/>

36 “Radio Evropa e Lire, “Vitia: Mos zgjidhni vakcina,” REL, 31 gusht 2021 <https://www.evropaelire.org/a/situa-ta-me-koronavirus/31437058.html>

37 Per kater muaj, 89% e te vdekurve nga COVID-19 ne Kosove ishin te pavaksinuar,” Koha Ditore, 13 dhjetor 2021 <https://www.koha.net/arberi/301104/per-kater-muaj-89-e-vdekjeve-nga-covid-19-ishin-te-pavaksinuar/>

Figura 2

Shkalla e vdekjeve nga COVID-19 bazuar në statusin e vaksinimit në Kosovë në periudhën 5 gusht - 1 dhjetor 2021.

Burimi: Ministria e Shëndetësisë, Institutit Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës dhe USAID



Të dhënat e mësipërme ofrojnë një vështrim të shpejtë mbi ngurrimin ndaj vaksinimit në Kosovë. Teksa shkalla e vdekjeve korrespondon me përhapjen e variantit Delta (varianti më ngjites dhe më vdekjeprurës i COVID-19) në verën e vitit 2021 në Kosovë dhe heqjen e detyrimit për mbajtje të maskave dhe ndalimit të tubimeve për të inkurajuar dhe akomoduar vizitat nga diaspora kosovare, fakti që 89% e vdekjeve ishin në mesin e të pavaksinuarve në një kohë kur vaksinat ishin gjerësisht të disponueshme në Kosovë, tregon për ngurrimin e përhapur ndaj vaksinimit.

Ky konstatim konfirmohet më tej nga të dhënat nga grupet e fokusit të organizuara si pjesë e këtij studimi nga QKSS në Prishtinë dhe nga Barometri i Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP) i kryer mes datave 17 shtator – 21 shtator 2021, që tregojnë se dezinformimi dhe polarizimi politik minuan besimin e publikut tek qeveria dhe luajtën rol kyç në nxitjen e ngurrimit ndaj vaksinimit të publikut, duke e sfiduar për pasojë menaxhimin e pandemisë.

RREGULLIMI LIGJOR DHE ASPEKTI I POLITIKAVE PËR DEZINFORMIMIN DHE KEQINFORMIMIN NË KOSOVË

Dezinformimi, edhe pse cilësohet si fenomen i dëmshëm, nuk konsiderohet i paligjshëm.³⁸ Megjithatë, ai mund t'u nënshtrohet kufizimeve të ngushta kur plotësohen disa kërkesa të paracaktuara. Gjatë shpërthimit të COVID-19, ndikimi i dëmshëm i dezinformimit në shëndetin publik u bë më i dukshëm, duke i detyruar vendet të miratojnë urgjentisht masa ligjore për ta luftuar informacionin e rremë.

Por kufizimi i rrjedhës së hapur të informacionit, që konsiderohet si standard i rëndësishëm demokratik, mbetet një masë jopopullore në shoqëritë demokratike dhe veçanërisht në demokracitë liberale. Për shkak të vijës së hollë që ndan kufizimin e lirisë së shprehjes nga lufta kundër dezinformimit, shumë shtete ngurrojnë të miratojnë ligje që synojnë ta kufizojnë informacionin.

Kosova është ndër vendet që nuk ka përdorur mjete juridike për t'iu përgjigjur dezinformimit, edhe pse ka legjislacion të miratuar rishtazi në lidhje me parandalimin dhe luftimin e pandemisë. Dokumentet themelore të vendit të mishëruara në kushtetutën e tij, garantojnë lirinë e shprehjes,³⁹ dhe nuk parashohin dispozita apo përjashtime që do të lejonin kufizimin e kësaj të drejte për mbrojtjen e shëndetit publik. Sipas Kushtetutës, kjo liri mund të hiqet vetëm kur rregullohet me ligj dhe kur është e nevojshme për të parandaluar nxitjen e dhunës ose urrejtjes. Megjithatë, duke qenë se Kushtetuta i përcakton dhe garanton të drejtat e njeriut sipas tetë instrumenteve dhe marrëveshjeve ligjore ndërkombëtare,⁴⁰ është e rëndësishme të shqyrtohen në mënyrë kritike implikimet ligjore dhe përgjegjësitë e shteteve sipas këtyre instrumenteve. Ndër instrumentet që përcaktojnë dhe garantojnë lirinë e shprehjes janë Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Të dy instrumentet përcaktojnë se liria e shprehjes mund të kufizohet kur është e nevojshme për mbrojtjen e një qëllimi legjitim që shkon nga siguria kombëtare dhe rendi publik tek shëndeti publik, dhe kur kufizimi lejohet nga ligji vendor.⁴¹ Në të gjitha rastet, kufizimi duhet të jetë mjeti më pak ndërhyrës për arritjen e qëllimit legjitim. Duke qenë se Kosova nuk ka një ligj që lejon kufizimin e informacionit të rremë në lidhje me shëndetin publik, kufizimi prej akterëve shtetërorë i informacionit të rremë mund të konsiderohet si kufizim i

38 GRNL i Komisionit Evropian, 2018, fq.10

39 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 40

40 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22

41 KNDCP, neni 19.3; KEDNJ, neni 10.2

paligjshëm i lirisë së shprehjes. Për rrjedhojë, edhe në situatat kur dezinformimi ka ndikim të dëmshëm si në rastin e pandemisë, shteti nuk mund të veprojë ligjërisht kundër tij.

Megjithatë, një dezinformim i tillë mund të kufizohet përmes mënyrave të ndryshme. Për shembull, shumica e platformave të rrjeteve sociale kanë algoritme të reja automatike për raportim dhe sinjalizim të postimeve që përmbajnë informacion në lidhje me pandeminë. Megjithatë, këto tipare automatike nuk janë përshtatur në gjuhë të ndryshme, duke përfshirë edhe gjuhën shqipe, çka paraqet sfida për Kosovën.

MJEDISI INFORMATIV I KOSOVËS GJATË COVID-19

Përkundër sasive të mëdha të lajmeve të rreme, dezinformimit rreth pandemisë COVID-19 dhe informacioneve të kufizuara për virusin dhe pandeminë, shumica e mediave kosovare kanë arritur të ofrojnë informacione të besueshme për risqet dhe kërcënimet nga COVID-19.⁴² Zyrtarët e shëndetësisë publike në Kosovë vlerësojnë se mediat u kanë ndihmuar të rrisin vetëdijesimin për COVID-19, si dhe argumentojnë se mediat kryesore të Kosovës kanë luajtur rol të rëndësishëm për bindjen e publikut që t'i respektojë masat kundër COVID-19 të vendosura nga qeveria.⁴³

Megjithatë, përpjekjet e mediave që të prodhonin dhe t'i ofronin publikut informacion të besueshëm rreth COVID-19, u sfiduan nga prania e lajmeve të rreme dhe konspiracioneve për virusin dhe pandeminë në rrjetet sociale dhe media digjitale. Prania e teorive konspirative, dezinformimit dhe lajmeve të rreme në rrjetet sociale në Kosovë, pati efekte të dëmshme tek perceptimi publik për pandeminë si kërcënim dhe pranimi i kufizimeve institucionale për parandalimin e pandemisë.⁴⁴ Ky efekt u ndërlikua më tej nga paqëndrueshmëria politike e Kosovës, çka krijoi një terren pjellor për lajme të rreme dhe dezinformim rreth COVID-19.⁴⁵ Institucionet, mediat dhe publiku nuk ishin të përgatitur për t'iu kundërvënë propagandës dhe dezinformimit që hidhnin dyshime rreth ekzistencës së COVID-19, masave mbrojtëse kundër COVID-19 dhe vaksinimit.⁴⁶

Në kontekstin e Kosovës, kemi identifikuar dy kategori të individëve dhe grupeve që kanë promovuar informacione të rreme për pandeminë. Grupi i parë ishin ata që kundërshtuan ekzistencën e virusit dhe shpallën se pandemia ishte krijuar dhe planifikuar nga individë që duan të kontrollojnë botën.⁴⁷ Kjo kategori ndikohej nga narrativat e lëvizjeve globale, të cilat bazohen në paragjykime antisemite në përpjekjet e tyre për përhapje të lajmeve të rreme për ekzistencën dhe origjinën e virusit. Kjo narrativë përqendrohet tek hebrenjtë si personat që qëndrojnë pas përhapjes së virusit ose si personat që do të përfitojnë drejtpërdrejt nga pandemia për të vazhduar dominimin e tyre mbi financat dhe teknologjitë globale. Narrativa ishte motërzim i historive të ngjashme që gjenden mes neo-nazistëve dhe grupeve të tjera të djathta ekstreme në Evropën Perëndimore dhe mes supremacistëve të bardhë në

42 Intervistë me përfaqësues të lartë të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës. 20 mars 2021.

43 Po aty:

44 Avdiu, P., 2021. Mes mohimit dhe reagimit: Perceptimet e qytetarëve mbi menaxhimin e COVID-19 nga institucionet e Kosovës. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Në dispozicion në: <https://qkss.org/en/publikimet/mes-mohimit-dhe-reagimit-perceptimet-e-qytetareve-mbi-menaxhimin-covid-19-nga-institucionet-e-kosoves/>

45 Diskutim në grup fokusi me qytetarë të Kosovës i lehtësuar nga QKSS në Prishtinë më 8 shkurt 2022

46 Diskutim në grup fokusi me përfaqësues institucionalë i lehtësuar nga QKSS në Prishtinë më 27 tetor 2021.

47 Intervistë me përfaqësues të lartë të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës. 20 mars 2021.

SHBA.⁴⁸ Në Kosovë, këto konspiracione synonin t'i portretizonin institucionet dhe politikanët e Kosovës si të kontrolluar nga filantropi hebre George Soros dhe nga miliarderi hebrej dhe kompanitë e tyre, që ta përhapin pandeminë për të ndihmuar agjendën globale të hebrejve.⁴⁹

Figura 3

Shembull i një narrative online që krahason COVID-19 me Armët e Shkatërrimit në Masë, duke aluduar se është krijuar qëllimisht nga fuqitë perëndimore.

Burimi: Facebook 



Një tjetër narrative e shpërndarë nga grupet e dezinformimit ishte se pandemia COVID-19 ishte rezultat i garës mes fuqive të mëdha për kontroll mbi ekonominë dhe informacionin botëror. Këtu i janë referuar posaçërisht garës me SHBA-së, Kinës dhe Rusisë, dhe aleatëve më të vegjël të SHBA-së si Mbretëria e Bashkuar dhe Izraeli. Kjo narrative e konkurrencës globale kishte dy nën-narrativa që e përforconin këtë teori të veçantë konspirative, por përmes dy këndvështrimeve të ndryshme. E para lidhej me dominimin prej SHBA-së duke reduktuar popullsinë botërore, përmes targetimit të vendeve lindore posaçërisht. Sipas kësaj narrative, qëllimi i Perëndimit është shfarosja e popullsisë së vendeve të ashtuquajtura të “Botës së Tretë”, si mënyrë për të adresuar sfidat e veta të sigurisë.⁵⁰ Sipas kësaj logjike, në versionin kosovar të kësaj nën-narrative Kosova konsiderohet si vend i “botës së tretë” dhe për këtë arsye është cak i fushatës së shpopullimit. Nën-narrativa e dytë lidhet me garën për rrjetin 5G mes Perëndimit dhe Kinës. Sipas pjesëmarrësve të grupit të fokusit, “nëpërmjet garës 5G, Kina po përpiqet të dominojë botën, të kontrollojë informacionin dhe teknologjinë botërore dhe të zvogëlojë dominimin teknologjik global të SHBA-së”.⁵¹

48 Debat televiziv në Shqipëri. Alfred Cako flet mbi axhendën e pandemisë së Covid 19 . Rrethi Katror. Qasur më 18 mars 2022.

49 Po aty.

50 Debat televiziv në Shqipëri. “Profecite” e Alfred Cakos për vaksinën, cipat e 5G. Qasur më 3 maj 2022. Në dispozicion në: <https://www.youtube.com/watch?v=ncYyjbqKs-4>

51 Diskutim në grup fokusit me qytetarë të Kosovës i lehtësuar nga QKSS në Prishtinë më 8 shkurt 2022

Figura 4

Shembull i një postimi online që promovon një narrativë të rremë se COVID-19 është pjesë e një fushate shpopullimi.

Burimi: Facebook 



Grupi i dytë që përhapi dezinformim në Kosovë, i cili sipas të gjithë treguesve ishte grupi më i spikatur, ishin ata që besonin në ekzistencën e virusit, por nuk e pranonin kërcënimin e virusit. Një pjesë e këtij grupi janë persona që bëjnë thirrje kundër vaksinimit, që përhapin në mënyrë aktive informacione të rreme dhe lajme të rreme për të minuar procesin e vaksinimit duke hedhur dyshime mbi procesin e licencimit, efektin e mundshëm anësor dhe pasojat afatgjata për ata që dëshirojnë të vaksinohen. Sipas këtij grupi, COVID-19 ekziston, por rreziku prej tij është i ngjashëm me viruset e tjera dhe nuk shkakton vdekje. Një nga argumentet kryesore të përdorura në këtë narrativë është debati mbi cilësinë e vaksinave që janë aktualisht në treg. Në rastin e Kosovës, vëzhgimet në grupe të fokusit dhe rrjete sociale për qëllimet e këtij raporti, tregojnë se ata që bëjnë thirrje kundër vaksinimit janë më të shumtë në numër krahasuar me ata që nuk e pranojnë ekzistencën e virusit. Personat anti-vaks në Kosovë mendojnë se është e drejtë e qytetarit të vendosë nëse dëshiron të vaksinohet apo jo.⁵² Sipas personave anti-vaks, “nëse individit ka dyshime për cilësinë e mjekimit ose vaksinës, ai ose ajo ka të drejtë të vendosë ta marrë ose jo vaksinën”. Argumenti i tyre kryesor është se nuk ka pasur transparencë në lidhje me përbërësit e vaksinës, si dhe periudhën e testimit të vaksinave.⁵³ Kjo kategori individësh pretendon se vaksinat kundër COVID-19 janë prodhuar brenda një viti dhe nuk i kanë kaluar procedurat standarde të testimit të vaksinave.⁵⁴

52 Debat televiziv në Kosovë. Protestohet kundër maskave dhe vaksinave. Qasur më 10 mars 2022. Në dispozicion në: <https://www.youtube.com/watch?v=knWUtOe7lbM&t=1079s>

53 Po aty.

54 Po aty.

Figura 5

Dy shembuj të narrativës që i portretizon vaksinat si joefektive, vdekjeprurëse dhe pjesë të një zhvillimi "gjeopolitik".

Burimi: Facebook  dhe një agjenci e lajmeve online




TEORITË KONSPIRATIVE DHE DEZINFORMIMI RRETH COVID-19

Në përputhje me trendet globale, kategoria e parë promovoi idenë se COVID-19 u krijua nga organizata të "industrisë së madhe farmaceutike" që kujdesen për interesat e tyre të biznesit. Kjo narrativë u përshtat me kontekstin lokal dhe qytetarët e Kosovës u targetuan përmes platformave të rrjeteve sociale, duke përfshirë Facebook dhe YouTube, të dyja me ndikim në të gjitha gjeneratat. Burimet e rrjeteve sociale ishin të mbushura me postime që pretendonin se organizata dhe individë të fuqishëm ndërkombëtarë, si George Soros, Bill Gates, Fondacioni Rockefeller, ishin organizatorët e pandemisë.⁵⁵ Këta individë dhe organizata, vazhdonin teoritë konspirative, kontrollonin qeveritë, mediat, partitë politike dhe botën akademike që prodhonin teori të sajura për ekzistencën e COVID-19 për të mundësuar zbatimin e agjendës së tyre. Promovuesit e kësaj teorie besojnë se OBSH është institucioni më i rëndësishëm ndërkombëtar i kontrolluar nga kompani dhe individë të pasur, të cilët nëpërmjet saj ushtrojnë kontroll në shkallë globale. Ata pretendojnë se mjekët janë të detyruar të heshtin e të mos ta thënë të vërtetën për Covid-19.⁵⁶

Figura 6

Shembull i portretizimit të vaksinave si agjendë për përfitime financiare nga individë të fuqishëm.

Burimi: Facebook 



55 Debat televiziv në Shqipëri. Divorci i çiftit Gates, Alfred Cako zbulon teorinë konspirative që e shoqëron. Qasur më 4 mars 2022. Në dispozicion në: <https://www.youtube.com/watch?v=GSC5HmyqhkE>

56 Po aty


Këta ndjekës kanë pretendime të ngjashme për kontrollin mbi vaksinimin kundër COVID-19. Ata besojnë se vakcina u prodhua për të shkatërruar sistemin imunitar të trupit të njeriut për ta bërë më të prekshëm nga sëmundje si kanceri dhe sulmi në zemër tek gjenerata e vjetër dhe që targetojnë sistemin riprodhues të brezit të ri me objektiv kryesor uljen e popullsisë botërore në të ashtuquajturat vende të botës së tretë. Kjo narrativë u shpërfaq në platforma të ndryshme të rrjeteve sociale në Kosovë, duke ngritur dyshime rreth vaksinës tek gjenerata e të rinjve, të cilët përbëjnë shumicën e popullsisë së vendit.

Narrativa e kontrollit përfshinte edhe teori për gjurmimin e mundshëm të qytetarëve përmes implantimit të një çipi elektronik në trupin e njeriut përmes vaksinave. Për këtë grup fajtori ishin kompanitë e mëdha të teknologjisë me qëllimin e tyre të supozuar për të gjurmuar dhe kontrolluar popullsinë e botës. Kjo teori konspirative u përhap në masë të madhe në Kosovë dhe ndikoi në qëndrimet e qytetarëve për t'i rezistuar vaksinimit.⁵⁷

Figura 7

Dy shembuj të përhapjes së teorive për gjurmimin e mundshëm të qytetarëve nëpërmjet implantimit të një çipi elektronik në trupin e njeriut përmes vaksinave.

Burimi: Facebook 



57 Digital 2022: Të dhëna për Kosovën. Vegza: <<https://datareportal.com/reports/digital-2022-kosovo>> Accessed 17 April 2022.

Kosova është vendi me penetrimin dhe numrin më të lartë të përdoruesve të internetit në rajon dhe Evropë. Të dhënat e hapura të besueshme tregojnë se Kosova kishte 1.72 milionë përdorues të internetit në janar 2022. Shifrat tregojnë se shkalla e penetrimit të internetit në Kosovë ishte 97.0 për qind e popullsisë së përgjithshme në fillim të vitit 2022. Të dhënat e publikuara nga burimet e META-s për reklama tregojnë se në Kosovë janë rreth 869,200⁵⁸ përdorues të Facebook-ut. Veç tyre, Kosova ka 582,900 përdorues aktivë të Instagram-it. Duke shtuar numrin e qytetarëve të Kosovës që kanë qasje në platforma të tjera të rrjeteve sociale si LinkedIn, Twitter, Telegram, ky numër është afër 2 milionë përdorues.⁵⁹ E gjithë popullata e rritur në Kosovë ka qasje në të paktën një ose dy platforma të rrjeteve sociale, duke e bërë publikun shumë të cënueshëm ndaj dezinformimit.

Në diskutimet e grupeve të fokusit, të anketuarit ngritën dyshime mbi sistemin e kujdesit shëndetësor të Kosovës dhe menaxhimin e COVID-19 prej tij, duke i përzier këto shqetësime me konspiracionet për zvogëlimin e popullsisë. Sipas këtyre të anketuarve, mjekët qëllimisht i vranë pacientët me COVID-19 për të zvogëluar numrat e popullatës, veçanërisht të të moshuarve.⁶⁰ Kjo narrativë ka pasur veprim frenues ndaj raportimit të infektiveve me COVID-19 në institucionet shëndetësore në Kosovë, duke e komplikuar menaxhimin e pandemisë dhe duke bërë që shumë njerëz të kërkojnë kura alternative për trajtim, ndonjëherë me efekt vdekjeprurës.⁶¹ Deri më sot, Kosova nuk ka asnjë projeksion zyrtar për numrin e vërtetë të të infektuarve me koronavirus.

Për shembull, një të anketuari në një grup fokusi në Prishtinë i kishin thënë se "ekziston një marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, mjekëve, spitaleve dhe politikanëve, që të mos trajtohen pacientët që janë të infektuar me virusin dhe kanë sëmundje të tjera të rënda dhe t'i lënë ta përballojnë vetë virusin dhe sëmundjet e tjera". Ndjenja dhe raportime të ngjashme bëjnë bujë në rrjetet sociale.

Janë pikërisht këto teori konspirative dhe thashetheme që kanë frenuar përpjekjet e hershme për vaksinim në Kosovë. Përkundër progresit në fund të vitit 2021 dhe në vitin 2022, fushata e vaksinimit pati një fillim sfidues, ndoshta sepse qëndrimet e qytetarëve ndaj vaksinimit ishin formësuar nga dezinformimi dhe nxiteshin nga mosbesimi i përgjithshëm tek institucionet, siç tregohet nga shembujt e mësipërm dhe shtjellohet më tej në pjesën vijuese të këtij raporti.

58 Po aty.

59 Po aty.

60 Intervistë me zyrtar të lartë të Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës.

61 Po aty.

REALITETET E PERCEPTUARA DHE COVID-19: PASQYRA E PERCEPTIMEVE PUBLIKE

- Perceptimet publike ndaj menaxhimit të pandemisë
COVID-19
- Perceptimet e publikut ndaj dezinformimit



Perceptimet publike ndaj menaxhimit të pandemisë COVID-19

Studiuesit që studiojnë menaxhimin e pandemisë dhe reagimin e publikut kanë treguar lidhjen e drejtpërdrejtë mes besimit të publikut tek institucionet dhe arritjeve më të mira në përballimin e COVID-19.⁶² Ekspertët e shëndetësisë publike kanë theksuar ndikimin negativ të politizimit të pandemisë dhe kanë argumentuar se konotacioni politik rreth çështjeve të shëndetit publik zvogëlon hapësirën për informim adekuat dhe minon legjitimitetin e institucioneve shëndetësore publike.⁶³ Si besimi tek institucionet ashtu edhe politizimi i çështjeve të shëndetit publik janë dy faktorë që ndikojnë tek perceptimi i publikut rreth çështjeve të shëndetit publik, duke rezultuar në një mjedis me potencial më të lartë për depërtimin e dezinformimit.

Në rastin e Kosovës, siç u argumentua më herët në këtë raport, periudha e pandemisë u karakterizua me mungesë të stabilitetit politik, çka i la në hije çështjet e shëndetit publik dhe uli besimin e publikut tek institucionet. Në vitin 2020, sipas anketës së Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP), vetëm 13 për qind e të anketuarve thanë se kanë besim ose kanë besim të plotë tek Qeveria e Kosovës.⁶⁴ Po atë vit, qytetarët e Kosovës shprehën pakënaqësi me menaxhimin e pandemisë nga institucionet qendrore që zhvilluan dhe miratuan politikatat e lidhura me menaxhimin e pandemisë dhe formësuan përgjigjen kombëtare.⁶⁵ Nga ana tjetër, institucionet e ngarkuara me zbatimin e këtyre politikave dhe reaguesit e parë, siç janë mjekët, spitalet dhe Policia e Kosovës, janë vlerësuar pozitivisht në përballjen me krizën e pandemisë.⁶⁶ Këta të fundit gëzonin nivel më të lartë besimi në krahasim me institucionet qendrore.⁶⁷ Këto të dhëna tregojnë një lidhje potenciale mes besimit të qytetarëve tek institucionet dhe kënaqshmërisë së tyre me menaxhimin e krizës së pandemisë nga institucionet përkatëse.

Në anketën e BSBP 2021, besimi tek qeveria u përmirësua. Tridhjetë e gjashtë për qind e të anketuarve thanë se kanë besim ose kanë besim të plotë tek Qeveria, ndërsa 41 për qind thanë se kanë shumë pak besim ose aspak

62 Taylor, A., 2021. *Studiuesit pyesin pse disa vende ishin më të përgatitura për Covid. Përgjigja befasuese: kishin besim.* [online] Washington Post. Në dispozicion në: <https://www.washingtonpost.com/world/2022/02/01/trust-lancet-covid-study/?fbclid=IwAR3FFlgZmhw-ur_-01RNuKCW24NKx9Cf9DcCh9zIND7VMd1OWLsXuu6Km1w>.

63 RTK Live, 2021. *SHBA, politizimi krijoi probleme në menaxhimin e pandemisë.* [online] Në dispozicion në: <https://www.rtklive.com/sq/news-single.php?ID=495714>.

64 Balaj, Sh., 2021. *Besimi i qytetarëve të Kosovës ndaj institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë.* Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

65 Avdiu, P., 2021. *Mes mohimit dhe reagimit: Perceptimet e qytetarëve mbi menaxhimin e COVID-19 nga institucionet e Kosovës.* Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Në dispozicion në: <https://qkss.org/en/publikimet/mes-mohimit-dhe-reagimit-perceptimet-e-qytetarëve-mbi-menaxhimin-covid-19-nga-institucionet-e-kosoves/>

66 Po aty.

67 Balaj, Sh., 2021. *Besimi i qytetarëve të Kosovës ndaj institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë.* Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

besim.⁶⁸ Rritja e besimit pasqyron edhe nivelin e kënaqshmërisë së qytetarëve me menaxhimin e pandemisë nga Qeveria dhe institucionet tjera qendrore.







Në këtë drejtim, për dallim nga viti 2020 kur 26 për qind e të anketuarve të BSBP-së e vlerësuan menaxhimin e pandemisë nga qeveria si të mirë apo të shkëlqyer, në vitin 2021 opinion pozitiv kishin 40 për qind e të anketuarve. Rritje e kënaqshmërisë në këtë drejtim vërehet edhe me Kuvendin dhe Presidenten e vendit, ndonëse kjo e fundit nuk ka luajtur rol të drejtpërdrejtë në politikëbërje apo menaxhimin e pandemisë. Tridhjetë e katër për qind e të anketuarve të BSBP-së e shohin si të mirë ose të shkëlqyer punën e Kuvendit në drejtim të menaxhimit të situatës së pandemisë, ndërsa 46 për qind aprovojnë punën e Presidentes.

Nga ana tjetër, ka vazhduar trendi rritës në kënaqshmërinë e qytetarëve me menaxhimin e pandemisë nga institucionet e "vijës së parë", përkatësisht spitalet, Policia e Kosovës dhe autoritetet komunale. Në këtë drejtim, 69 për qind e të anketuarve të BSBP-së e konsiderojnë si të mirë apo të shkëlqyer menaxhimin e situatës së pandemisë nga spitalet, ndërsa 60 për qind kanë opinion të tillë për autoritetet komunale. Policia e Kosovës gëzon perceptimin më pozitiv në lidhje me mënyrën si e ka trajtuar pandeminë, me 73 për qind të të anketuarve që e vlerësojnë si të mirë apo të shkëlqyer punën e saj në këtë drejtim. Në të njëjtën kohë, Policia e Kosovës është një nga institucionet publike më të besueshme në Kosovë, çka potencialisht tregon lidhjen ndërmjet besimit dhe perceptimeve rreth gatishmërisë për menaxhimin e pandemisë.

68 Balaj, Sh., 2021. *Perceptimet e qytetarëve për integritetin e institucioneve publike në Kosovë*. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Në dispozicion në: <https://qkss.org/en/publikimet/perceptimi-i-qytetareve-per-integritetin-e-institucioneve-publike-ne-kosove>

Tabela 1

Perceptimet e qytetarëve për mënyrën si e trajtuan situatën e pandemisë COVID-19 institucionet e Kosovës⁶⁹

	Nuk e di/ nuk kam opinion	Shumë dobët	Dobët	Deri diku	Mirë	Shkëlqye- shëm
 Qeveria	1%	12%	18%	29%	31%	9%
 Kuvendi	2%	13%	19%	31%	28%	7%
 Presidentja	2%	12%	14%	26%	31%	15%
 Komunat	2%	7%	9%	22%	44%	16%
 Institucionet shëndetësore	1%	6%	7%	14%	46%	26%
 Policia e Kosovës	1%	6%	6%	14%	47%	26%

69 The data have been retrieved from Western Balkans Security Barometer - Kosovo Database. For more information on this project and the methodology of data collection, please refer to: <https://qkss.org/al/publikimet/perceptimi-i-qytetareve-per-integritetin-e-institucioneve-publike-ne-kosove>

Kënaqshmëria e qytetarëve të Kosovës me institucionet publike në përballjen me pandeminë COVID-19 shtrihet edhe në menaxhimin e procesit të vaksinimit. Kështu, 61 për qind e të anketuarve të BSBP-së besojnë se Qeveria në përgjithësi dhe Ministria e Shëndetësisë në veçanti kanë qenë të mira apo të shkëlqyera në menaxhimin e procesit të vaksinimit, ndërsa 67 për qind kanë opinion të tillë për institucionet/spitalet shëndetësore dhe autoritetet komunale.⁷⁰ Perceptimet për menaxhimin e procesit të vaksinimit mund të lidhen me përvojën e drejtpërdrejtë të qytetarëve, pasi 73 për qind e të anketuarve të BSBP-së deklaruan se janë të vaksinuar. Megjithatë, në lidhje me këtë, dhjetë për qind e të anketuarve deklaruan se refuzojnë të vaksinohen dhe kur u pyetën pse, 56 për qind thanë se nuk u besonin vaksinave kundër COVID-19, ndërsa pjesa tjetër shprehën mungesë besimi ndaj OBSH-së, institucioneve shëndetësore lokale, ose e lidhën arsyetimin e tyre me probleme shëndetësore.

Perceptimet e publikut ndaj dezinformimit

Siç u shpjegua më herët në raport, shkalla e penetrimit të internetit në Kosovë është ndër më të lartat në Evropë, ndërsa përdorimi i rrjeteve sociale nga qytetarët e Kosovës është gjithashtu në shkallë shumë të lartë. Kjo potencialisht ka ndikuar që fokusi i mediave të zhvendoset drejt pranisë së zgjeruar online, çka vitet e fundit ka sjellë një gjendje të re të peisazhit mediatik në Kosovë. Kjo ka çuar në një "treg të mbipopulluar" të mediave lokale, duke rritur gjithashtu potencialin për prodhimin e pafiltruar të lajmeve dhe përhapjen e dezinformimit dhe përmbajtjeve të tjera të dëmshme.⁷¹

Po ashtu, mediat u vunë nën presion të paprecedent gjatë pandemisë. Në vitin 2021, disa gazetarë ishin subjekt i formave të ndryshme të sulmeve dhe kërcënimeve, përfshirë rastin e drejtorit të një agjencie të lajmeve online, i cili u mor në pyetje nga Policia e Kosovës për raportimin e agjencisë për një çështje të lidhur me vaksinat kundër COVID-19.⁷²

Armiqësia kundër mediave ka nxitur potencialisht një perceptim negativ të publikut të Kosovës ndaj mediave, si dhe ekspozimin e Kosovës ndaj dezinformimit. Në këtë aspekt, sipas të dhënave të BSBP-së, 40 për qind e të anketuarve kanë shumë pak besim ose nuk kanë aspak besim tek mediat, 31 për qind kanë besim deri diku, ndërsa 28 për qind shprehin besim apo besim të plotë tek mediat. Për më tepër, shumica e pjesëmarrësve të një grupi të

70 Po aty.

71 Hoxha, A., 2020. *PEISAZHI MEDIATIK NË KOSOVË: Urrejtja dhe ndikimet e propagandës*. SEENPM, Peace Institute & Kosovo 2.0. Në dispozicion në: <https://seenpm.org/wp-content/uploads/2020/10/Resilience-research-publication-1-KOS-ENG.pdf>

72 Raportet e Vendeve për Praktikën e të Drejtave të Njeriut 2021: Kosova. Departamenti i Shtetit i SHBA

fokusit të lehtësuar nga QKSS-ja për nevojat e këtij raporti, i shohin mediat si të anshme politikisht dhe të nxitura nga interesat financiare të pronarëve të tyre.⁷³ Në mënyrë të ngjashme, përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme të Kosovës që morën pjesë në diskutimin e një grupi tjetër të fokusit të lehtësuar nga QKSS-ja, e lidhin rolin e dezinformimit mediatic me perceptimet negative ndaj institucioneve në Kosovë.⁷⁴

Përkundër besimit të ulët tek mediat dhe peisazhit të perceptuar mediatic, 57 për qind e të anketuarve të BSBP-së e konsiderojnë televizionin publik (RTK) dhe rrjetet e tjera televizive private si burimin parësor të informimit, ndërsa 39 për qind i konsiderojnë agjencitë e lajmeve online dhe rrjetet sociale si burimet e tyre parësore të informimit.

Tabela 2

Besimi i qytetarëve të Kosovës tek mediat





Tabela 3

Burimet parësore të informimit të qytetarëve të Kosovës




73 Diskutim në grup fokusi me qytetarë të Kosovës i lehtësuar nga QKSS në Prishtinë më 8 shkurt 2022.

74 Diskutim në grup fokusi me përfaqësues institucionale i lehtësuar nga QKSS në Prishtinë më 27 tetor 2021.

Edhe pse një pjesë e madhe e të anketuarve të BSBP-së mbështeten në rrjetet sociale dhe agjencitë e lajmeve online për informim, shumica e tyre prej 78 për qind besojnë se rrjetet sociale dhe agjencitë e lajmeve online janë burimi parësor i dezinformimit në Kosovë, ndërsa 20 për qind kanë opinion të tillë për rrjetet televizive. Për më tepër, pjesëmarrësit e grupeve të fokusit shohin një korrelacion mes dezinformimit dhe agjencive të vogla të lajmeve online dhe atyre që varen financiarisht nga bizneset ose interesat politike.⁷⁵ Sipas këtyre perceptimeve, në kohën e mjegullës informative që ishte fillimi i pandemisë COVID-19, pjesëmarrësit e grupeve të fokusit thanë se për informacione në lidhje me pandeminë mbështeteshin te agjencitë e huaja të lajmeve dhe ekspertët mjekësorë me të cilët kishin lidhje personale.⁷⁶

Tabela 4

Perceptimi i qytetarëve të Kosovës se kush është burimi kryesor i dezinformimit



Pavarësisht opinionit të pjesëmarrësve të grupeve të fokusit në lidhje me burimet e tyre të informimit për çështjet e lidhura me COVID-19, rezultatet e BSBP-së tregojnë se vetëm 11 për qind e të anketuarve besojnë se dezinformimi ndikon në çështjet e shëndetit publik. Kjo tregon mungesën e vetëdijesimit se si mundet dezinformimi të ndikojë në aspekte të shëndetit publik, duke treguar për rrjedhojë potencial më të lartë për konsumim të informacionit jo të saktë në lidhje me shëndetin publik. Shumica e të anketuarve të BSBP-së e njohin efektin e dezinformimit në çështjet e lidhura me politikën, ku 45 për qind e të anketuarve janë të opinionit se dezinformimi ndikon në besimin e qytetarëve tek institucionet publike dhe 28 për qind e të anketuarve besojnë se dezinformimi ndikon në orientimin politik të qytetarëve.

75 Diskutim në grup fokusi me qytetarë të Kosovës i lehtësuar nga QKSS në Prishtinë më 8 shkurt 2022.

76 Po aty.

Tabela 5

Perceptimi i qytetarëve të Kosovës se cilat janë fushat ku dezinformimi ka ndikimin më të madh në Kosovë



- 6% ■ Nuk e di/Nuk kam opinion
- 45% ■ Në besimin e qytetarëve për institucionet publike
- 29% ■ Në orientimin politik të qytetarëve
- 11% ■ Në çështjet e shëndetit publik
- 7% ■ Në sigurinë nacionale
- 2% ■ Tjetër
- 2% ■ Asnje nga të sipërmjet

KONKLUSIONE

Ky raport konstaton se institucionet, mediat dhe publiku nuk ishin të përgatitur për t'iu kundërvënë propagandës dhe dezinformimit që hidhnin dyshime rreth ekzistencës së COVID-19, masave mbrojtëse kundër COVID-19 dhe vaksinimit. Në këtë drejtim, përkundër përpjekjeve të tyre për të komunikuar çdo ditë me publikun, institucionet e Kosovës nuk arritën të krijojnë një sistem komunikimi për trajtimin e lajmeve të rreme dhe për menaxhimin e një përgjigjeje efektive kombëtare për frenimin e përhapjes së informacionit të rremë – si dezinformim ashtu edhe keqinformim – rreth virusit dhe pasojave të tij.

Fokusi i këtij raporti nuk është përcaktimi i marrëdhënies së drejtpërdrejtë shkak-pasojë mes polarizimit politik dhe politizimit të masave kundër COVID-19 dhe shkallës së infektimit, shkallës së vaksinimit dhe shkallës së vdekjeve, por që përmes shembujve dhe metodave të ndryshme të tregojë se mungesa e një mesazhi konsistent dhe të unifikuar dhe hedhja e akuzave dhe kundërakuzave për menaxhimin e pandemisë që e rënduan peisazhin politik të Kosovës në vitet 2020 dhe 2021, ishin faktorë kontribuues në rezultatet e përziera të Kosovës në menaxhimin e pandemisë.

Raporti përfundon më tej se përpjekjet e mediave që t'i ofrojnë publikut informacion të besueshëm rreth COVID-19, u sfiduan nga prania e lajmeve të rreme dhe konspiracioneve për virusin dhe pandeminë në rrjetet sociale dhe media digjitale. Prania e teorive konspirative, dezinformimit dhe lajmeve të rreme në rrjetet sociale në Kosovë, pati efekte të dëmshme tek perceptimi publik për pandeminë si kërcënim dhe pranimi i kufizimeve institucionale për parandalimin e pandemisë.

Raporti ka identifikuar dy kategori të individëve dhe grupeve që kanë promovuar informacione të rreme për pandeminë në Kosovë. Grupi i parë përfshin ata që nuk e pranonin ekzistencën e virusit dhe shpallën se pandemia ishte vepër e akterëve të fuqishëm, ndërsa në grupin e dytë përfshihen ata që besojnë në ekzistencën e virusit, por nuk e pranonin kërcënimin e virusit. Raporti më tej konstaton se këto grupe janë gjithashtu të ndikuar nga narrativat e lëvizjeve globale, të cilat bazohen në paragjykime antisemite në përpjekjet e tyre për përhapje të lajmeve të rreme për ekzistencën dhe origjinën e virusit. Brenda këtyre grupeve, raporti identifikoi narrativa të ndryshme të përdorura për shpërndarje të dezinformimit. Narrativa të tilla përfshijnë teorinë konspirative se pandemia COVID-19 ishte rezultat i garës me fuqive të mëdha për kontroll mbi ekonominë dhe informacionin botëror, duke e portretizuar COVID-19 edhe si një mjet të Perëndimit për shfarosjen e popullsinë e të ashtuquajturave vende të "Botës së Tretë" për të adresuar sfidat e veta të sigurisë. Sipas kësaj logjike, në versionin kosovar të kësaj nën-narrative Kosova konsiderohet si

vend i "botës së tretë" dhe për këtë arsye është cak i fushatës së shpopullimit. Për më tepër, raporti konstaton se një prej narrativave dominuese ishte ideja se COVID-19 ekziston, por rreziku prej tij është i ngjashëm me viruset e tjera dhe nuk shkakton vdekje. Raporti më tutje konstaton se ata që bëjnë thirrje kundër vaksinimit janë më të shumtë në numër në krahasim me ata që nuk e pranojnë ekzistencën e virusit, prandaj një narrativë e shpeshtë që haset në Kosovë është kontestimi i procesit të licencimit të vaksinave që janë aktualisht në treg.

Gjetjet e këtij raporti theksojnë nevojën edhe më emergjente për një plan të centralizuar të komunikimit strategjik nga institucionet e Kosovës. Rrjedhimisht, bazuar në përvojën e pandemisë COVID-19 dhe mësimet e nxjerra nga shqyrtimi i mjedisit informativ të Kosovës në të cilin u zhvillua menaxhimi i pandemisë, institucionet e Kosovës duhet të zhvillojnë një strategji të qartë dhe gjithëpërfshirëse komunikimi për çështjet që kanë të bëjnë me mirëqenien e publikut – duke përfshirë kriza shëndetësore, emergjencat natyrore dhe kërcënimet e sigurisë kombëtare – që siguron ndarje konkrete dhe të qarta të roleve dhe veprimeve në të gjitha nivelet e qeverisjes. Për më tepër, një strategji e tillë duhet të parashikojë edhe konceptimin e kundër-narrativave për luftimin e dezinformimit dhe keqinformimit rreth çështjeve të shëndetit publik dhe emergjencave të tjera kritike. Institucionet e Kosovës duhet gjithashtu të bëjnë analiza sistematike dhe ta demaskojnë dezinformimin rreth çështjeve të shëndetit publik, efektin e tyre në shoqëri dhe format në të cilat ato shpërndahen, në mënyrë që përgjigja ndaj tyre të jetë efektive dhe konkrete. Në këtë drejtim, komunikimi i institucioneve duhet të jetë në përputhje me zhvillimet digjitale dhe avancimin e platformave të ndryshme të komunikimit, në mënyrë që shtrirja e informatave të verifikuara dhe zyrtare të përkohë me përdorimin e platformave të ndryshme online që shfrytëzohen nga qytetarët e Kosovës.

Katalogimi në botim (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës - "Pjetër Bogdani"

32.019.5:616.9(496.51)(047)

Balaj, Shpat

Ndikimi i dezinformimit dhe polarizimit politik gjatë pandemisë Covid-19 në Kosovë / Shpat Balaj, Skënder Perteshi. - Prishtinë : QKSS, 2022. - 29 f. : ilustr. ; 24 cm.

Propaganda -- Opinioni publik

Sëmundjet ngjithës -- COVID-19 -- Raporte -- Kosovë

1. Perteshi, Skënder

ISBN 978-9951-799-64-5

Aleph [000102449]

www.qkss.org

ISBN 978-9951-799-64-5



9 789951 799645